



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
Opština Glogovac / Municipality of Gllogoc



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njërzore/ Jedinica za Single Resource Manager

Duke u bazuar në nenet 77,78,79,80 dhe 81 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 pika 1.2 dhe nenit 5 pika 2 të Udhëzimit administrative MFPT-NR.01/2024 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, paragrafi 1 i nenit 33 të ligjit nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik si dhe aprovimit Nr.06-111/01-34623 dt.22.07.2024 së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Drenasit shpallë:

KONKURS

(I brendshëm)

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Nr. I references: RN00015051

-Kryeinfermier/e - një (1) vend i lirë;

-Kordinator i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Parësor Shëndetësor - një (1) vend i lirë;

Titulli i vendit të punës: 1 (një) Kryeinfermier/e në QKMF Drenas

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Gllogocit

Lloji i pozitës: Kryeinfermier/e

Numri i Pozitave: Një (1) në QKMF Drenas

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtorit të – QKMF-së

Paga: H14-Cd_256; 6/660

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar (4 vite)

Orë pune në javë: 40

Afati i aplikimit: 07.09.2024 e deri në ora 16:00 të datës 06.10.2024

Detyrat dhe Përgjegjësit për Kryeinfermier/e

- Organizon, respektivisht menaxhon me kuadrin e mesëm shëndetësor, nëpërmes Infermierëve përgjegjës të Sektoreve në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Familjare;
- Organizon dhe është përgjegjëse për hartimin me kohë të raporteve të ndryshme (mujore, tremujore e vjetore);
- Është përgjegjës për realizimin e planeve në drejtim të edukimit dhe të përsosjes së personelit të mesëm shëndetësor;
- Përkujdeset për nivelin e higjienës në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Familjare si dhe në hapësirat tjera punuese;
- Përcjell dhe ndihmon aktivitetet në kuadër të Sektorit të Shëndetit Publik;
- Përkujdeset për furnizim të rregullt me material të nevojshëm harxhues nëpër sektore;
- Përcjellë orarin, disiplinën dhe punën e punëtorve në të gjitha sektoret e Mjekësisë Familjare dhe raporton për të njëjtat;
- Bashkëpunon ngushtë me të gjitha sektoret në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Familjare;
- Bën kërkesa të nevojshme për shërbime gjegjëse në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Familjare;
- Kujdeset për shfrytëzimin e drejtë të mjeteve të punës në kuadër të Departamentit;
- Kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Drejtorit të QKMF-së dhe në bazë të Rregullores së brendshme ;
- Për punën e vet i përgjigjet Drejtorit të QKMF-së;

Kushtet dhe kriteret për Kryeinfermier/e:

- Përgaditja profesionale: Infermieri (Fakulteti i Infermierisë, Shkolla e Mesme- Infermieri e Përgjithshme);
- Licenca e punës lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë- OIK,
- Dokumenti identifikues kopje,
- Të jetë banorë i Republikës së Kosovës,
- Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i/e përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të këtyre shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip, si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja dhe të punës me kompjuter;
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulturë, etnike, religjioni apo race.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fletëaplikacioni i plotësuar;
- Kopja e Diplomës së Fakultetit/ Shkollës së Mesme e Mjekësisë (e noterizuar);

- Dëshmia se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Jetëshkrimi (CV);
- Kopja e letëmjuftimit apo e pasaportës;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarin në institucion publik i cili ka bërë shpallje të konkursit);
- Çertifikata mjekësore (pas përzgjedhjes);
- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (deri 10 pikë)
- Testi më shkrim (deri 70 pikë)
- Intervista me gojë (deri 20 pikë).

I. Titulli i vendit të punës: Koordinator i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore

Në Kujdesin Parësor Shëndetësor

Institucioni: QKMF “Dr.Hafir Shala” - Komuna e Drenasit/Gllogocit

Lloji i pozitës: Koordinator i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Parësor Shëndetësor

Numri i Pozitave: Një (1) në QKMF

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtorit të – QKMF-së

Paga: deri 20 % e pages bazë.

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar – katër (4) vite.

Orë pune në javë: 40

Afati i aplikimit: **07.09.2024 e deri në ora 16:00 të datës 06.10.2024**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përpilon, vlerëson dhe koordinon planin dhe programin institucional për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore;
- Bashkëpunon me udhëheqësin e institucionit shëndetësor dhe inicon themelimin e komitetit të cilësisë, komisioneve të tjera si atë për audit klinik dhe hulumtim, organizim të rishqyrtimit kolegjial dhe të ngjajshme, të përcaktuara me statut apo akte nënligjore të niveleve të kujdesit shëndetësor;
- Mbikqyr zbatimin e dokumenteve të cilat sigurojnë praktikën e mirë mjekësore;
- Monitoron zbatimin e standardeve të cilësisë;
- Evidenton mangësitë dhe propozon masat për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;

- Siguron shërbime konsultative sipas statutit të institucionit shëndetësor, për trupat menaxhuese, profesionistët shëndetësor dhe bashkëpunëtorët profesional dhe jo profesional, me qëllim të zbatimit të standardeve të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
- Përcjell zhvillimet e reja në fushën e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
- Bashkëpunon me të gjitha komisionet e institucionet për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore;
- Menaxhon dosjet e komitetit të sigurisë dhe cilësisë për institucionin shëndetësor;
- Harton raporte periodike për drejtorin e Institucionit shëndetësor;
- Harton raportin vjetor dhe përmes drejtorit të institucionit shëndetësor përmes e përcjell në DCSShSh në Ministrinë e Shëndetësisë.
- Orari i punës së koordinatorit është me gjysëm orari, kryen punën si coordinator, kurse gjysmën tjetër të orarit e kryen në punën bazë;
- Nëpunëset/it në shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe në kujdesin parësor shëndetësor, që ushtrojnë funksione udhëheqëse që nuk janë pjesë e shtojcave të këtij ligji përfitojnë shtesë të posaçme për ushtrimin e funksionit përkatës. Vlera e shtesës sipas këtij paragrafi nuk mund të kalojë njëzet përqind (20 %) të pagës bazë.

Kushtet dhe kriteret për Koordinator të Cilësisë:

- Për pozitën e koordinatorit mund të konkurojnë të gjithë profesionistët shëndetësorë ose bashkëpunëtorët profesional me shkollim të lartë në menaxhment shëndetësor;
- Trajnime në fushën e menaxhimit shëndetësorë
- 3 (tre) vite përvojë pune në profesion;

Kushtet e preferueshme:

- Trajnime për Menaxhim Shëndetësor.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fletëaplikacioni i plotësuar;
- Kopja e Diplomës së Fakultetit/ Shkollës së Mesme e Mjekësisë (e noterizuar);
- Dëshmia se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Jetëshkrimi (CV);
- Kopja e letëmjoftimit apo e pasaportës;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarin në institucion publik i cili ka bërë shpallje të konkursit);
- Çertifikata mjekësore (pas përzgjedhjes)
- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.

•

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (deri 10 pikë)

- Testi më shkrim (deri 70 pikë)
- Intervista me gojë (deri 20 pikë).

Procedurat e konkurimit:

Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët që kanë marrëdhënie pune me institucionin publik që ka bërë shpalljen e konkursit pa dallim, të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe dispozitat e Ligjit të Punës, të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Qarkores Informativ Nr.01/2019 dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **07.09.2024 e deri në ora 16:00 të datës 06.10.2024.**

Informata të përgjithshme:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në Zyrën për Shërbim me Qytetarë nga ora 08:00-16:00 cdo ditë pune në sportelet 10,11,12 në Komunën e Drenasit, aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga web-faqja <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje sepse dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi përmes email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumentet origjinale të kualifikimit që i kanë kryer.

Në rast të mos dorëzimit të dokumentacionit original, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet do të publikohen në portal shtetëror: <https://konkursi.rks-gov.net> si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.